



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMEVE, MONITORIMIT DHE ZBATIMIT TE KONTRATAVE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____ .01.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje (funizim/vendosje) materialeve të nevojshme për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe shesheve të Bashkisë Fier”

Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik fitues, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 36 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Asfalt, çakëll dhe rërë bitumi” 14213000-7, “Asfalt bitumi” 14213100-8,

VLERA E FONDIT LIMIT/ vlera e pritshme : 249 470 651.69 (dyqind e dyzet e nëntë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 23.01.2025): 2 538 366.41 (dy milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje dyzetë e një) Euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është ne kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te përcaktuar se: *4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitetin ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2021, 2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **150 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë që nuk tejkalon dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejmë te përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: **Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të**

xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm është në perpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/a e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit dhe Rregullat e Prokurimit Publik, për të mundësuar pjesëmarrje me të gjere të operatoreve ekonomike të interesuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 3 (tre) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **90 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur

të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; **dhe,**
- ii.** Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **90 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Vlera e furnizimeve të mëparshme të ngjashme në vlerën jo më pak se **90 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet / vlerës së pritshme të marreveshjes kuader, i jep siguri AK që operatorët ekonomikë kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për realizimin e objektit të kontratës.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:

- i.** Inxhinier ndërtimi 1 (një);

Inxhinieri i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin **Janar 2025**. Për inxhinierin duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme).

b) Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kësaj marrëveshje kuadër/kontrate, duhet të ketë në stafin e tij, me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës, edhe inxhinierin si më poshtë:

i. Inxhinier Gjeodet/ Topograf 1 (një);

Për Inxhinierin e sipërcituar duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë pune (e vlefshme).

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si më poshtë:

- Buldozerist 3 (tre); (në listë pagesë ose me kontratë pune)
- Automakinist 1 (një); (në listë pagesë ose me kontratë pune)
- Shofer me leje drejtimi C 2 (dy); (në listë pagesë ose me kontratë pune)

Për specialistet e sipërcituar duhet të paraqiten deshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre, si dhe kontratë individuale të punës e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të kontratës.

Shënim: Për pikat **a)**, **b)** dhe **c)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat **a)**, **b)** dhe **c)** të pikës **2.3.2**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në pikën 5/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme). Vendosja e këtij kriteri për disponimin e punonjësve / personelit kryesor është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e realizimit të kontratave përgjate gjithë vlefshmerisë së

marreveshjes kuader dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te tyre. Përlllogaritja e fuqisë punëtore dhe makinerive është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”,(sipas portalit SIM në e-albania), bazuar ne Kodin e Punes se Republikes se Shqiperise me ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 9125 date 29.07.2003 si dhe me ligjin 10053 dt. 29.12.2008, bazuar ne preventivat . Afati i realizimit i ardhur me shkresen 10407 prot., dt 11.10.2024 nga Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit te Puneve Publike dhe Investimeve ndryshuar me shkresen me nr. 49 prot., date 06.01.205 per anullimin e procedures se meparshme dhe shtimin e stabilizantit si dhe si dhe afati i realizimit te rrugeve do te behete 3 vjecar si dhe ne shkresen me nr. 588 prot, date 15.01.2025 e ardhur nga Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit te Puneve Publike dhe Investimeve si dhe referuar Pikave te licencës së firmës/ave janë nxjerrë bazuar në VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar . Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për pregatitjen teorike- praktike të kandidateve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i perdorimit te makinerive te ndertimit"

- **2.3.3** Operatori Ekonomik duhet te ketë fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej jo me pak se **4 punetor dhe 1 inxhinier Ndertimi, pra 5 punonjes** për **muajin Janar 2025, pa perfshire :**
Buldozerist 3 (tre); Automakinist 1 (një); Shofer me leje drejtimi C 2(dy); Inxhinier Gjeodet/ Topograf 1 (një)

Shënim: Për pikën **2.3.3** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.3**, duke dorezuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- a)** Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Janar 2025**.
- b)** Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Janar 2025**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratave. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e realizimit të kontratave përgjate gjithë vlefshmerisë së marrëveshjes kuader. Për llogaritjen e numrit të punonjësve për realizimin e kontratave jemi bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur realizimin e kontratave përgjate periudhës 36 muaj të vlefshmerisë së marrëveshjes kuader, bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, (sipas portalit SIM në e-albania), si dhe në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë me ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 9125 date 29.07.2003 si dhe me ligjin 10053 dt. 29.12.2008.

Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit **muajin Janar 2025** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave, bazuar në ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe të pagesës*), ku përcaktohet se operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda dates 20 të muajit pasardhës.

2.3.4 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e objektit të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë license profesionale për realizim punimesh, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

a) Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

1. **N.P. - 4 Klasifikimi “A”** (*Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*).

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar si dhe ne zerat e preventivit

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e shtresave që do të realizohen, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Sipas tabelës së fondit limit
NP – 4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	Per zerat e preventivit nr.1,2,3	A	Sipas tabelës së fondit limit

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:

a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.9):

NR	EMERTIMI I MAKINERISE	SPECIALIST MAKINERISH	NR I MAKINERIV E	Statusi
1	Asfaltoshtruese	Buldozerist	1	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi
2	Autobitumatriçe	Automakinist	1	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi
3	Rul (kompresor) me vibrim	Buldozerist	2	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi
4	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtes nën 10 ton për transportin e	Shofer me leje drejtimi C	2	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit në fuqi

	materialit ne rruget e shesheve te lagjeve te cilat jane te ngushta			
5	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Shofer me leje drejtimi C	2	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit ne fuqi
6	Autobot	Automakinist	1	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit
7	Grejder	Buldozerist	1	Me pronesi ose me qira ose sipas legjislacionit

Shënim: Për pikën **2.3.5 (a)** si më sipër, për operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 (a)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- i. Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.**
- ii. Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet **dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerave, e vlefshme.**
- iii. Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- iv. Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.

- b)** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë kapacitetet teknike si më poshtë:

Fabrikë asfaltbetoni - 1 copë – në pronësi ose me qira ose kontratë furnizimi.

Shënim: Për pikën **2.3.5 (b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën të plotësuar rregullisht me të gjitha të dhënat e kërkuara për kualifikim në këtë pikë, sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.5 (b)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Për fabrikën e asfaltbetonit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesi dokumentin që verteton pronesinë, Leje mjedisore me kod III.1.B (leshuar nga QKL).

Nëse **fabrika e asfaltbetonit** nuk është në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton posedimin e fabrikës (Kontrate qeraje e vlefshme, marreveshje furnizimi e vlefshme, etj.) e shoqëruar me dokumentin e pronesisë, dhe me Leje mjedisore me kod III.1.B (leshuar nga QKL).

Vendndodhja e fabrikës duhet të jetë në një largësi jo më të madhe se 50 km nga qendra e qytetit të Fierit, pasi është parashikuar të shtrihen jo vetëm e rruget brenda qytetit të Fierit por edhe rrugë në njesite administrative të Bashkisë Fier.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme, nëse e gjykon të arsyeshme, mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- a)** Kerkesat për makinerite/mjetet që nevojiten argumentohet në bazë të zerave të preventivit:

NR	EMERTIMI I MAKINERISE	SPECIALIST MAKINERISH	NR I MAKINERIVE	SHENIME	Statusi
1	Asfaltoshtruese	Buldozerist	1	Per zerin 1,2	Me pronesi ose me qira sipas legjislacionit ne fuqi
2	Autobitumatriçe	Automakinist	1	Per zerin 1,2	Me pronesi ose me qira sipas legjislacionit ne fuqi
3	Rul (kompresor) me vibrim	Buldozerist	2	Per zerin 1,2,3	Me pronesi ose me qira sipas legjislacionit ne fuqi
4	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtes nen 10 ton per transportin e materialit ne rruget e shesheve te lagjeve te cilat jane te ngushta	Shofer me leje drejtimi C	2	Per zerin 1,2,3	Me pronesi ose me qira sipas legjislacionit ne fuqi
5	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Shofer me leje drejtimi C	2	Per zerin 1,2,3	Me pronesi ose me qira sipas legjislacionit ne fuqi
6	Autobot	Automakinist	1	Per zerin 3	Me pronesi ose me qira sipas legjislacionit ne fuqi
7	Grejder	Buldozerist	1	Per zerin 3	Me pronesi ose me qira sipas legjislacionit ne fuqi

Shenim: Përlllogaritja e makinerive është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”,(sipas portalit SIM në e-albania)

Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike- praktike të kandidatëve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit"

b) Kërkesa për fabriken e asfaltobetonit argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM Nr 628 date 15.07.2015 “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugeve.....specifikimet” (fq 7116 e VKM për perzjerjet bituminoze) citohet se: “E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes së përzierjes nuk lejohet të jetë më shumë se 2 (dy) orë”

Duke patur parasysh se një kamion që transporton, sipas rregullave të qarkullimit rrugor qarkullon me shpejtesi mesatare 45-50 km/ore dhe duke patur parasysh plotësimin e kushtit prej 2 orësh për përmbijlljen e procesit të shtrimit nga përlllogaritjet rezulton:

Mbushja e kamionit referuar fabrikave (50 deri 100 ton/ore) 10 minuta

Procesi i shkarkimit, vendosjes dhe ngjeshjes së materialit

(për kapacitet kamioni 10-12 ton & An 3.222/2) 54 minuta

Koha e mbetur për transport materialit 56 minuta

Për 56 minuta dhe kamion me shpejtesi mesatare 45-50 km/ore vendodhja e fabrikes së asfaltobetonit duhet të jete 46.67 km.

Përgjithësisht Shpejtesia Maksimale e një kamioni i mbushur në rrugë është 60 km /ore dhe bosh 80 km/ore shenim ky që ndodhet i stampuar në pjesën e prapme të kamionave.Duhet pastur parasysh që këto mjete do të levizin në rruget e qyteteve si dhe të Njesive administrative. Pavarësisht nga kapaciteti i prodhimit të asfaltit (50-400) ton/ore, pra prodhimi i materialit në fabrike nëq ingradientet janë gati do 1 orë vetëm prodhimi i tyre.

Pra për realizimin e këtij objekti Subjekti duhet të ketë kontratë furnizimi, në pronësi apo me qera një fabrike asfaltobetonit. Distanca maksimale për vendndodhjen e fabrikes së asfaltit rezulton të jete 50 km nga qendra e qytetit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”

Specifikimet teknike janë vendosur referuar materialit të hartuar nga Strukturat e Posaçme Drejtoria e Projekteve të infrastruktures dhe Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit të Puneve Publike dhe Investimeve, përcjellë me shkresën nr.10108 prot., datë 03.10.2024 “Shkresë Percjellese”, shkresën me nr. 9400/3 prot., date 04.10.2024 me lende “Percjellje dokumentacioni”, si dhe shkresën nr. 10407/1 prot., 11.10. 2024 me lende “Percjellje dokumentacioni per fondin limit”, si dhe Bazuar në shkresën me nr. 49 prot., date 06.01.205 për anulimin e procedurës së mëparshme dhe shtimin e stabilizantit si dhe afati i realizimit të rrugëve do të bëhet 3 vjeçar si dhe në shkresën me nr. 588 prot, date 15.01.2025 e ardhur nga Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit të Puneve Publike dhe Investimeve bashkëngjitur DST në SPE.

Kriteret teknike të kualifikimit në lidhje me stafin mbështetës, makineri , punëtorë , licenca janë hartuar nga grupi i punës dhe janë dërguar me shkresën me nr. 11582 prot., date 06.11.2024, kurse ndryshimet për shkak të shtimit të zerit janë pasqyruar në procesverbalin e mbajtur me date 20.01.2025 në Drejtorinë e Prokurimit Publik.

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST në SPE.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e prokurimit:

